



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3147/ 6 prot

Datë 16/12/2025

V E N D I M
K.P.P. 1861/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16/12/2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “VASAA” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62824-09-26-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike per sistemin e ndricimit rrugor dhe aksesore (shtylla ndriçimi,krahe një degshe etj)”, me fond limit 12,948,800 (dymbëdhjete milion e nentëqind e dyzet e tete mije e teteqind) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 14.10.2025, nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për pjesën e mbetur të arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “VASAA” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62824-09-26-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike per sistemin e ndricimit rrugor dhe aksesore (shtylla ndriçimi,krahe një degshe etj)”, me fond limit 12,948,800

(dymbëdhjetë milion e nentëqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 14.10.2025, nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier.

Mbetjen të skualifikuar të ofertës së operatorit ekonomik “Ervin Luzi” Person fizik, operatorit ekonomik “ZEQIRI” SHPK dhe operatorit ekonomik “GENERAL TRADING” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “VASAA” SHPK me NIPT J62903470T, dhe me adresë: *Lagjia “KRYENGRITJA E FIERIT”, Fier.*

Autoriteti Kontraktor:

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier
Adresa: Lagja “11 Janari”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Fier.

Subjekte të interesuar:

Operatori ekonomik “Ervin Luzi” Person fizik me NIPT: K71707007Q, dhe me adresë: *Kashar Tiranë Kashar, YRSHEK, Lagjia “Katund i Ri”, Rruga “Ali Pashë Gucia”, Godina nr.5.*

Operatori ekonomik “ZEQIRI” SHPK me NIPT: J67902827A, dhe me adresë: *Lagjia “Bishanak”, Rruga “Skenderbeu”, Zona Kadastrale 5532, Banesë private , Pasuria nr. 1/1088, Kati I-rë, Fier.*

Operatori ekonomik “GENERAL TRADING” SHPK me NIPT: M21501011F, dhe me adresë: *Zona kadastrale 2953, Nr. pasurie 72/28, Rruga “Ben Mjalti”, Njësia Administrative Pezë. Pezë, Tiranë.*

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.09.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62824-09-26-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike per sistemin e ndricimit rrugor dhe aksesore (shtylla ndriçimi,krahe një degshe etj)”, me fond limit 12,948,800 (dymbëdhjete milion e nentëqind e dyzet e tete mije e teteqind) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 14.10.2025, nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier.

II.2. Në datën 14.10.2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt-ankimi.

II.3. Më datë 28.10.2025 autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin e ofertave si vijon:

1	“Ervin Luzi” P.F	8.785.000 leke	skualifikuar
2	“ZEQIRI” SHPK	9.280.000 leke	skualifikuar
3	“General Trading” SHPK	10.092.000 leke	skualifikuar
4	“VASAA” SHPK	10.601.000 leke	skualifikuar
5	“Sark” SHPK	10.675.000 leke	skualifikuar
6	“Modeste” SHPK	12.387.000 leke	skualifikuar
7	“Arteo 2018” SHPK	12.595.000 leke	skualifikuar
8	“Kalia” SHPK	12.916.500 leke	skualifikuar
9	“Hest” SHPK	12.917.500 leke	skualifikuar

II.4. Në datën 28.10.2025, operatori ekonomik “VASAA” ShPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës “VASAA” SHPK. me NUIS J62903470T, konstatoi mangësitë si më poshtë:

1- Referuar Shtojcës 8, në pikën 1.a kerkohet qe operatori ekonomik te paraqese “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;”. Nga verifikimi i dokumentacionit te ngarkuar ne SPE rezulton qe operatori ekonomik nuk e ka ngarkuar kete formular ne permbushje te ketij kriteri.

2- Referuar Shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.1, përcaktohet se: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Ne kete rast vlere e kerkuar eshte jo me pak se 4 000 000 lekë pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Nga kqyrja e dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik, KVO konstatoi se: Subjekti paraqet ne sistem Vertetim me nr 231 prot date 12.02.2025, per pune te ngjashme te kryera ne Bashkine Lushnje me vlere 4 495 512 leke me TVSH. Nga perlllogaritjet e kryera vlere pa TVSH e kesaj kontrate eshte 3 746 260 lek. Pra vertetimi i paraqitur nuk e ploteson kushtin e kerkuar ne SPE.

3- Referuar Shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.2, përcaktohet se:

“Ofertuesi duhet te paraqese katalog/katalogje ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve per zerat e mallrave sipas tabelës së mëposhtme, me të dhënat teknike, ku të jenë të përcaktuar zerrat e mallrave dhe specifikimet teknike të tyre. Në katalog/katalogje duhet të markohet produkti që ofrohet. Emertimet e mallrave në tabelën e mëposhtme për të cilat duhet të paraqiten katalogë, i përkasin zerave 4 dhe 5 të preventivit të Shtojcës nr.7” Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” në DST. [Nëse materiali /et të cilat do të paraqiten për të përmblirë kriterin e mësipërm janë në gjuhë të huaj, ato duhet të përkthehen në shqip për pjesën e të dhënave teknike të kërkuara si dhe të notëzuarat].

Tabela me zerrat e mallrave për të cilat duhet të paraqiten katalogë:

Nr. Emertimi i mallrave

4 Ndricues rrugor LED 100 W

5 Ndricues rrugor LED 150 W

Në përmblirje të këtij kriteri, operatori ekonomik, ka ngarkuar në SPE “Fragment katalogu» i cili nuk është i përkthyer

Referuar kërkesave ligjore për prokurimin publik, e pasqyruar edhe në DST, përcaktohet se:

”Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj duhet të shpërktohen nga një përkthim i notëzuar në gjuhën shqipe.” Referuar njoftimit të kontratës, në Seksioni 4: Procedura, pika 4.7 “Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat” është zgjedhur opsioni “shqip”.

KVO, pasi kaqyri fragmentët e katalogëve të mësipërm, konstatoi se:

Për zërin me nr. Rendor 4 “Ndricues rrugor LED 100 W”:

- nuk gjen pasqyrim informacioni “Mbulesa e sipërme polipropilen i përforcuar”.*
- nuk gjenë pasqyrim informacioni “Trupi i ndricuesit alumin i derdhur dhe i lyer me bojë poliestër”.*

Për zërin me nr. Rendor 5 “Ndricues rrugor LED 150 W”:

- nuk gjenë pasqyrim “Mbulesa e sipërme polipropilen i përforcuar”.*
- nuk gjenë pasqyrim “Trupi i ndricuesit alumin i derdhur dhe i lyer me bojë poliestër”*

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 80, nenit 92/3 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 79, nenit 80, nenit 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, e shpall të pavlefshme këtë ofertë, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, duke e skulifikuar atë.”.

II.5. Më datë 29.10.2025, autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2025/6045, datë 04.11.2025 dhe me numër protokoll nr. 3147/2025, datë 04.11.2025 e operatorit ekonomik “VASAA” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62824-09-26-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike per sistemin e ndricimit rrugor dhe aksesore (shtylla ndriçimi,krahe një degshe etj)”, me fond limit 12,948,800 (dymbëdhjete milion e nentëqind e dyzet e tete mije e teteqind) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 14.10.2025, nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, konstatohet se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “VASAA” SHPK.

Gjithashtu operatori ekonomik “VASAA” SHPK, kërkon mbetjen të skualifikuar të ofrave të paraqitura nga operatorë ekonomikë “Ervin Luzi” Person fizik, “ZEQIRI” SHPK dhe GENERAL TRADING” SHPK në këtë procedurë prokurimi.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit me Nr. 3147/1 Prot datë 05.11.2025, në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “VASAA” SHPK, si dhe mbetjen të skualifikuar të ofrave të paraqitura nga operatorë ekonomikë “Ervin Luzi” Person fizik, “ZEQIRI” SHPK dhe GENERAL TRADING” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.8. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier ka dërguar shkresën nr. 795/12 prot, datë 10.11.2025 “Dërgohet vendimi i KSHA në lidhje me ankesën për vlerësimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale elektrike per sistemin e ndricimit rrugor dhe aksesore (shtylla ndriçimi,krahe një degshe etj)”, me nr. REF-62824-09-26-2025”, protokolluar me tonën me nr. 3147/2 prot, datë 10.11.2025, ku informon Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “VASAA” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës me vendimin nr. 795/11 prot, datë 10.11.2025, e ka pranuar pjesërisht ankesën e ankimuesit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

Referuar formularit të ankesës së bërë nga operatori ekonomik "VASAA" SHPK, subjekt ankimues, pretendon se:

“Nuk është e vërtetë që Firma VASAA shpk, nuk ka ngarkuar Formuarin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas pikës 1/a të shtojcës 8, pasi Firma VISAA shpk ka ngarkuar në SPE Ekstrakrin Historik i Regjistrat Tregtar dhe Ekstraktin e Regjistrat Tregtar shharkuar

elektronikisht nga Platforma E-albania, me vulë elektronike nga Baza e të Dhënave të regjistrit të të dhënave të bizneseve QKB... Kështu që AK e ka aksesin për verifikim automatik dhe mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në bazën e të dhënave të platformës E-albania për Firma VASAA. Pra ky pretendim i AK-së nuk qëndron.”.

Nga shqyrtimi i të gjithë dokumentave të vëna në dispozicion nga Njësia e Prokurimit. dokumentave të hedhura në sistem prej operatorit ekonomik, si dhe çdo dokument tjetër të nevojshem të dosjes së tenderit. konstatoi se:

Referuar Procesverbalit nr. 3. "Mbi shvillimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të tenderit "E hapur e thjeshtuar", me mjete elektronike -me objekt: "Blerje mareriale elekirike peer sistemin e ndriçimit rrugor dhe aksesorë (shtylla ndriçimi,krahë një degshe etj” . nr. 795/5 Prot., datë 28.10.2025, mbajtur nga KVO, është pasqyruar një ndër arsyet e skualifikimit si më poshtë:

“Referuar Shtojcës 8, në pikën l/a kërkohet që operatori ekonomik të paraqesë "Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;". Nga verifikimi dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton që operatori ekonomik nuk e ka ngarkuar këtë formular në përmbushje të këtij kriteri. "

Pra, nga arsyeja e skualifikimit te KVO vërehet se operatori është skualifikuar për mungesë të paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. sipas shtojcës 8 të DST-se.

Këtë fakt KSHA e ka konstatuar dhe në dokumentat e hedhura në sistem prej operatorit ekonomik. nga aksesimi i krijuar në llogari si hetues. Çdo dokument i kërkuar në DST duhet të paraqitet nga operatori ekonomik në mënyrë që kriteri të cilësohet i përmbushur. Paraqitja e ekstraktit historik të regjistrimit tregtar dhe ekstrakti i regjistrimit tregtar nuk plotësojnë kushtin e paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit në kushtet kur nuk është i njëjti dokument.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik VASAA" SHPK nuk qëndron.

Gjithashtu, referuar Formularit të Ankesës, Operatori ekonomik "VASAA" SHPK , pretendon se: “Operatoti Ekonomik sipas shtojcës 8, kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik pika 2.3.1 duhet të paraqesë dëshmi për realizim me sukses të një ose disa kontratave të ngjajshme të realizuar gjatë 3 viteve të fundit me vlerë 4 000 000 leke, operatori ka paraqitur kontratë të ngjashme me vlerë 3.746.260 leke realizuar me Bashkinë Lushnje. Ky pretendim nuk është i vërtetë, past firma VASAA shpk, përveç Kontratews me vërtetimin përkatës që ka realizuar me Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike Lushnje me vlerë 3.746.260 leke, ka hedhur në SPE dhe një kontratë të realizuar me Bashkinë Divjakë me vlerë 4.798.720 leke pa tvsh. Të dyja këto Kontrata kanë Vlerë 8.544.980 leke pa tvsh, pra është më e madhe se vlera 4.000.000 leke, që AK ka vendosur tek kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3.1 Pra pretendimi i AK-së nuk qëndron.”.

Sa më sipër, pretenduar KSHA aksesoi dokumentat e hedhura në sistem prej operatorit ekonomik, nga aksesimi i krijuar në llogari si hetues dhe konstaton se OE ka paraqitur në SPE:

- Kontratë publike me Bashkinë Lushnjë, nr.1392/4 prot, datë 12.12.2024 me objekt: "Blerje materiale elektrite për nevojat e NPP (koka ndriçimi LED dhe kablllo elektrike)", bashkëlidhur se cilës ka paraqitur, faturë shitje nr.589 datë 16.12.2024, faturë shitje nr.608 datë 23.12.2024, faturë shitje nr.609 datë 27.12.2024 dhe Vërtetim realizimi nr. 231 prot, datë 12.02.2025 me vlerë 3,746,260 pa TVSH.
- Kontratë publike me Bashkinë Divjakë, nr.866/12 prot, datë 31.03.2023 me objekt: "Blerje transformatori dhe pajisje mbrojtje për gabinën elektrike godina e Bashkisë si edhe materiale elektrike për ndriçimin e rrugëve", bashkëlidhur së cilës ka paraqitur, faturë shitje nr. 270 datë 11.04.2023, faturë shitje nr.314 datë 27.04.2023, dhe Vërtetim për realizimin e kontratës nr. 6758/1 prot, datë 19.12.2023 me vlerë 4,798,720 pa TVSH.

Pas këtij verifikimi KSHA konstaton se OE e ka përmbushur kriterin teknik pika 2.3.1 të DST-së.
Për këto arsye, pretendimi i subjektit ankimes qëndronë.

Referuar formularit të ankesës së bërë nga operatori ekonomik "VASAA" SHPK, subjekti "..... Firma VASAA shpk, ka hedhur në SPE Katalogun LED STRET LIGHT, nga Kompania KAYHIN. nga e cila ka hedhur në SPE Autorizim Prodhuesi të përkthyer dhe noterizuar në giuhën shqipe. Ka hedhur Fragment katalogu, faqja nr 11 e katalogut, (bashkangjitur) për artikujt Nr 4. Ndriçues rrugor Led 100, Nr 5 Ndriçues rrugor Led 150W. Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar tek Kërkesat e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik 2.3.2 SKEDË TEKNIKE. për dy zërat e produkteve me formatin e skedës teknike, por ka kërkuar vetëm katalogë ose fragmente katologu ku duhet të markohet produkli që ofrohet. Firma VASAA shpk, ka hedhur new SPE fragment katalogu fuqja 11 e katalogut LED STRET LIGHT të kompanise KAHIN, ku janë markuar: Ndriçues rrugor led 100w, artikulli nr 4 i kërkuar; dhe ndriçues rrugor led 150w, artikulli nr 5 i kërkuar (bashkangjitur)

Ndriçuesat e kërkuar	Ndriçuesat e Ofruar
Artikulli 4	Artikulli 4
Ndriçues Led 100w	Ndriçues Led 100w
Ac 85-265w	Ac 85-265w
IP 60	IP 65 (me shkallw më të lartë izolacioni)
10100 LM	12000 LM (me fluks më të lartë ndriçimi)

6000 K	6500 K (me ndriçim më të plotë)
--------	---------------------------------

Ndriçuesat e kërkuar	Ndriçuesat e Ofruar
Artikulli 5	Artikulli nr
Ndriçues Led 150w	Ndriçues Led 150w
Ac 85-265w	Ac 85-265w
IP 60	IP 65 (me shkallw më të lartë izolacioni)
15000 LM	18000 LM (me fluks më të lartë ndriçimi)
6000 K	6500 K (me ndriçim më të plotë)

Gjuha e fragment katalogut faqja nr 11, është gjuhë teknike, si në shqip dhe anglisht ka të njëjtat terma teknike, dhe në çdo katalog të të gjitha kompanive ndërkombëtare të prodhimit të Ndriçuesave rrugor Led këto janë terma standarte të institucioneve të certifikuara për të përcaktuar parametrat e ndriçuesave rrugor led sipas standarteve: EN 60598-1, EN 60529, EN 62722-2-1 Pra pretendimi i AK-së nuk qëndron."

Sa më sipër, pretenduar KSHA konstaton se referuar kërkesave ligjore për prokurimin publik. e pasqyruar edhe në DST përcaktohet se:

"Oferta, si dhe të gjithë korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës.

Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe."

Referuar njoftimit të kontratës, në Seksioni 4: Procedura, pika 4.7 "Gjuha (ëi) në të cilat mund të hartohen ofertat" është zgjedhur opsioni "shqip"

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik "VASAA" SHPK nuk qëndron.

* * *

Referuar formularit të ankesës së bërë nga operatori ekonomik "VASAA" SHPK, subjekti ankimues, pretendon se:

"Për serinë e mallrave me numër rendor 4.Ndriçues rrugor Led 100w, dhe numër rendor 5. Ndriçues Rrugor Led 150w nuk gjen pasqyrim informacioni mbulesa e sipërme polipropilen i përforcuar, trupi i ndriçuesit alumin i derdhur dhe i lyer me bojë polyester...

.... Firma VASAA shpk, ka një experiencë shumë të gjatë 30 vjeçare në fushën e tregtimit të materialeve të ndriçimit, materialeve elektrike, dhe në veçanti të materialeve të ndriçimit rrugor; me dy Inxhinier Elektrik të përfshirë në stafin e saj prej një kohe shumë të gjatë, me përvoja të suksesshme në tregtimin dhe zbatimin e tyre në tregun privat dhe public. Në bazë të kësaj experience ndriçuesat që janë ofruar në procedurën në fjalë janë me parametra më të mirë sesa ndriçuesat e kërkuar nga AK-ja ,dhe konkretisht :

-Me trup alumini të derdhur me IP 65 nivelin e mbrojtjes që ofron trupi i ndriçuesit LED ndaj kushteve atmosferike të pluhurit dhe ujit, me shkallë më të lartë izolacioni se sa e ka kërkuar AK-ja IP60, standarti EN 60598-1 / EN 60529 (IP65). Nuk e di ku e ka gjetur AK-ja shkallën e izolacionit IP60 ?, se nuk egziston

-Me Klas IK08 që është e rëndësishme, pasi ndriçuesi siguron një qëndrueshmëri të lartë ndaj goditjeve mekanike në ambiente publike të jashtme, standarti EN 62262 të cilën AK-ja nuk e ka kërkuar fare.

-Me Mbulesë Polipropilen që siguron një shpërndarje uniforme të dritës, standarti EN 60598-1

-Me qëndrueshmëri të trupit alumini dhe cast të ndriçuesit dhe jetëgjatësi

-Me Guarnicion të gomuar Kundër Ujit standarti EN 60529 që nuk lejon lagështirën të hyjë në trupin e ndriçuesit.(bashkangjitur fragmenti i katalogut)

Pra Pretendimi i AK-së nuk qëndron".

Sa më sipër, pretenduar KSHA konstaton se referuar specifikimeve teknike kërkuar nga AK, shkalla e izolacionit është për grupin optik **min IP 60** dhe jo IP 60.

Gjithashtu referuar specifikimeve teknike të AK dhe fragmentit të katalogut të OE, specifikimi "mbulesë me propilen" nuk gjen pasqyrim në katalog, ndërsa përsa i përket "trupit të ndriçuesit i derdhur dhe i lyer me bojë poliestër" sipas katalogut të OE trupi i ndriçuesit është alumin i derdhur por mungon elementi i lyer me bojë poliestër.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik "VASAA" SHPK qëndron pjesërisht.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes dhe rethanave të saj, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi analizoi pretendimet e ankimuesit të parashtruara në ankesë, pasi u konsultua me dispozitat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, gjykon se pretendimet e subjektit ankimues qëndrojnë pjesërisht, pasi nuk gjejnë mbështetje në fakte, në prova, në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020. "Për Prokurimin Publik", në VKM nr.285, datë 19.05.2021. "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe në DST.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 114, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik", dhe nenit 102, germa "b" të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "VASAA" SHPK. Për procedurën e prokurimit publik me objekt "Blerje materiale elektrike për sistemin e ndriçimit rrugor dhe aksesore (shtylla ndriçimi, krahë një degëshe etj)", me nr. REF-62824-09-26-2025, me fond limit 12 948 800 (dymbëdhjetë milion e nëntëqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind) leke pa TVSH, zhvilluar në datë 14.10.2025, nga Autoriteti Kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier.
2. Autoriteti Kontraktor të njoftojë subjektin ankimues, subjektet e interesuara dhe KPP, duke i komunikuar me shkrim këtë vendim, në përputhje me rregullat e prokurimit dhe Udhëzimet e APP-së.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”.

II.8. Me shkresën nr. 795/12 prot, datë 10.11.2025 “Dërgohet vendimi i KSHA në lidhje me ankesën për vlerësimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale elektrike për sistemin e ndriçimit rrugor dhe aksesore (shtylla ndriçimi, krahë një degëshe etj)”, me nr. REF-62824-09-26-2025”, protokolluar me tonën me nr. 3147/3 prot, datë 12.11.2025, autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “VASAA” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës me vendimin nr. 795/11 prot, datë 10.11.2025, e ka pranuar pjesërisht ankesën e ankimuesit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

Referuar formularit të ankesës së bërë nga operatori ekonomik "VASAA" SHPK, subjekt ankimues, pretendon se:

“Nuk është e vërtetë që Firma VASAA shpk, nuk ka ngarkuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas pikës 1/a të shtojcës 8, pasi Firma VASAA shpk ka ngarkuar në SPE Ekstraksin Historik i Regjistrat Tregtar dhe Ekstraksin e Regjistrat Tregtar shharkuar elektronikisht nga Platforma E-albania, me vulë elektronike nga Baza e të Dhënave të regjistrat të të dhënave të bizneseve QKB... Kështu që AK e ka aksesin për verifikim automatik dhe mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në bazën e të dhënave të platformës E-albania për Firma VASAA. Pra ky pretendim i AK-së nuk qëndron.”.

Nga shqyrtimi i të gjithë dokumentave të vëna në dispozicion nga Njësia e Prokurimit. dokumentave të hedhura në sistem prej operatorit ekonomik, si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm të dosjes së tenderit. konstatoi se:

Referuar Procesverbalit nr. 3. "Mbi shvillimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të tenderit "E hapur e thjeshtuar", me mjete elektronike -me objekt: "Blerje materiale elektrike për sistemin e ndriçimit rrugor dhe aksesore (shtylla ndriçimi, krahë një degëshe etj)" . nr. 795/5 Prot., datë 28.10.2025, mbajtur nga KVO, është pasqyruar një ndër arsyet e skualifikimit si më poshtë:

"Referuar Shtojcës 8, në pikën 1/a kërkohet që operatori ekonomik të paraqesë "Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;". Nga verifikimi dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton që operatori ekonomik nuk e ka ngarkuar këtë formular në përmbushje të këtij kriteri. "

Pra, nga arsyeja e skualifikimit të KVO vërehet se operatori është skualifikuar për mungesë të paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST-se.

Këtë fakt KSHA e ka konstatuar dhe në dokumentat e hedhura në sistem prej operatorit ekonomik, nga aksesimi i krijuar në llogari si hetues. Çdo dokument i kërkuar në DST duhet të paraqitet nga operatori ekonomik në mënyrë që kriteri të cilësohet i përmbushur. Paraqitja e ekstraktit historik të regjistrimit tregtar dhe ekstrakti i regjistrimit tregtar nuk plotësojnë kushtin e paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit në kushtet kur nuk është i njëjti dokument.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik VASAA" SHPK nuk qëndron.

Gjithashtu, referuar Formularit të Ankesës, Operatori ekonomik "VASAA" SHPK , pretendon se: "Operatoti Ekonomik sipas shtojcës 8, kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik pika 2.3.1 duhet të paraqesë dëshmi për realizim me sukses të një ose disa kontratave të ngjashme të realizuar gjatë 3 viteve të fundit me vlerë 4 000 000 leke, operatori ka paraqitur kontratë të ngjashme me vlerë 3.746.260 leke realizuar me Bashkinë Lushnje. Ky pretendim nuk është i vërtetë, past firma VASAA shpk, përveç Kontratave me vërtetimin përkatës që ka realizuar me Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike Lushnje me vlerë 3.746.260 leke, ka hedhur në SPE dhe një kontratë të realizuar me Bashkinë Divjakë me vlerë 4.798.720 leke pa tvsh. Të dyja këto Kontrata kanë Vlerë 8.544.980 leke pa tvsh, pra është më e madhe se vlera 4.000.000 leke, që AK ka vendosur tek kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3.1 Pra pretendimi i AK-së nuk qëndron."

Sa më sipër, pretenduar KSHA aksesoi dokumentat e hedhura në sistem prej operatorit ekonomik, nga aksesimi i krijuar në llogari si hetues dhe konstaton se OE ka paraqitur në SPE:

- Kontratë publike me Bashkinë Lushnje, nr.1392/4 prot, datë 12.12.2024 me objekt: "Blerje materiale elektrike për nevojat e NPP (koka ndriçimi LED dhe kablllo elektrike)", bashkëlidhur se cilës ka paraqitur, faturë shitje nr.589 datë 16.12.2024, faturë shitje nr.608 datë 23.12.2024, faturë shitje nr.609 datë 27.12.2024 dhe Vërtetim realizimi nr. 231 prot, datë 12.02.2025 me vlerë 3,746,260 pa TVSH.*
- Kontratë publike me Bashkinë Divjakë, nr.866/12 prot, datë 31.03.2023 me objekt: "Blerje transformatori dhe pajisje mbrojtje për gabinën elektrike godina e Bashkisë si edhe materiale elektrike për ndriçimin e rrugëve", bashkëlidhur së cilës ka paraqitur,*

faturë shitje nr. 270 datë 11.04.2023, faturë shitje nr.314 datë 27.04.2023, dhe Vërtetim për realizimin e kontratës nr. 6758/1 prot, datë 19.12.2023 me vlerë 4,798,720 pa TVSH.

Pas këtij verifikimi KSHA konstaton se OE e ka përmbushur kriterin teknik pika 2.3.1 të DST-së. **Për këto arsye, pretendimi i subjektit ankimues qëndron.**

Referuar formularit të ankesës së bërë nga operatori ekonomik "VASAA" SHPK, subjekti "..... Firma VASAA shpk, ka hedhur në SPE Katalogun LED STRET LIGHT, nga Kompania KAYHIN. nga e cila ka hedhur në SPE Autorizim Prodhuesi të përkthyer dhe noterizuar në giuhën shqipe. Ka hedhur Fragment katalogu, faqja nr 11 e katalogut, (bashkangjitur) për artikujt Nr 4. Ndriçues rrugor Led 100, Nr 5 Ndriçues rrugor Led 150W. Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar tek Kërkesat e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik 2.3.2 SKEDË TEKNIKE. për dy zërat e produkteve me formatin e skedës teknike, por ka kërkuar vetëm katalogë ose fragmente katalogu ku duhet të markohet produkli që ofrohet. Firma VASAA shpk, ka hedhur new SPE fragment katalogu fuqja 11 e katalogut LED STRET LIGHT të kompanise KAHIN, ku janë markuar: Ndriçues rrugor led 100w, artikulli nr 4 i kërkuar; dhe ndriçues rrugor led 150w, artikulli nr 5 i kërkuar (bashkangjitur)

Ndriçuesat e kërkuar	Ndriçuesat e Ofruar
Artikulli 4	Artikulli 4
Ndriçues Led 100w	Ndriçues Led 100w
Ac 85-265w	Ac 85-265w
IP 60	IP 65 (me shkallw më të lartë izolacioni)
10100 LM	12000 LM (me fluks më të lartë ndriçimi)
6000 K	6500 K (me ndriçim më të plotë)

Ndriçuesat e kërkuar	Ndriçuesat e Ofruar
Artikulli 5	Artikulli nr
Ndriçues Led 150w	Ndriçues Led 150w
Ac 85-265w	Ac 85-265w
IP 60	IP 65 (me shkallw më të lartë izolacioni)
15000 LM	18000 LM (me fluks më të lartë ndriçimi)
6000 K	6500 K (me ndriçim më të plotë)

Gjuha e fragment katalogut faqja nr 11, është gjuhë teknike, si në shqip dhe anglisht ka të njëjtat terma teknike, dhe në çdo katalog të të gjitha kompanive ndërkombëtare të prodhimit të ndriçuesave rrugor Led këto janë terma standarte të institucioneve të certifikuara për të përcaktuar parametrat e ndriçuesave rrugor led sipas standarteve: EN 60598-1, EN 60529, EN 62722-2-1 Pra pretendimi i AK-së nuk qëndron."

Sa më sipër, pretenduar KSHA konstaton se referuar kërkesave ligjore për prokurimin publik. e pasqyruar edhe në DST përcaktohet se:

"Oferta, si dhe të gjithë korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës.

Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe."

Referuar njoftimit të kontratës, në Seksioni 4: Procedura, pika 4.7 "Gjuha (ëi) në të cilat mund të hartohen ofertat" është zgjedhur opsioni "shqip"

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik "VASAA" SHPK nuk qëndron.

* * *

Referuar formularit të ankesës së bërë nga operatori ekonomik "VASAA" SHPK, subjekti ankimues, pretendon se:

"Për serinë e mallrave me numër rendor 4.Ndriçues rrugor Led 100w, dhe numër rendor 5. Ndriçues Rrugor Led 150w nuk gjen pasqyrim informacioni mbulesa e sipërme polipropilen i përforcuar, trupi i ndriçuesit alumin i derdhur dhe i lyer me bojë polyester...

.... Firma VASAA shpk, ka një experiencë shumë të gjatë 30 vjeçare në fushën e tregtimit të materialeve të ndriçimit, materialeve elektrike, dhe në veçanti të materialeve të ndriçimit rrugor; me dy Inxhinier Elektrik të përfshirë në stafin e saj prej një kohe shumë të gjatë, me përvoja të suksesshme në tregtimin dhe zbatimin e tyre në tregun privat dhe public. Në bazë të kësaj experience ndriçuesat që janë ofruar në procedurën në fjalë janë me parametra më të mirë sesa ndriçuesat e kërkuar nga AK-ja ,dhe konkretisht :

-Me trup alumin i derdhur me IP 65 nivelin e mbrojtjes që ofron trupi i ndriçuesit LED ndaj kushteve atmosferike të pluhurit dhe ujit, me shkallë më të lartë izolacioni se sa e ka kërkuar AK-ja IP60, standarti EN 60598-1 / EN 60529 (IP65). Nuk e di ku e ka gjetur AK-ja shkallën e izolacionit IP60 ?, se nuk egziston

-Me Klas IK08 që është e rëndësishme, pasi ndriçuesi siguron një qëndrueshmëri të lartë ndaj goditjeve mekanike në ambiente publike të jashtme, standarti EN 62262 të cilën AK-ja nuk e ka kërkuar fare.

-Me Mbulesë Polipropilen që siguron një shpërndarje uniforme të dritës, standarti EN 60598-1
-Me qëndrueshmëri të trupit alumini dhe cast të ndriçuesit dhe jetëgjatësi
-Me Guarnicion të gomuar Kundër Ujit standarti EN 60529 që nuk lejon lagështirën të hyjë në trupin e ndriçuesit.(bashkangjitur fragmenti i katalogut)
Pra Pretendimi i AK-së nuk qëndron".

Sa më sipër, pretenduar KSHA konstaton se referuar specifikimeve teknike kërkuar nga AK, shkalla e izolacionit është për grupin optik **min IP 60** dhe jo IP 60.

Gjithashtu referuar specifikimeve teknike të AK dhe fragmentit të katalogut të OE, specifikimi "mbulesë me propilen" nuk gjen pasqyrim në katalog, ndërsa përsa i përket "trupit të ndriçuesit i derdhur dhe i lyer me bojë poliestër" sipas katalogut të OE trupi i ndriçuesit është alumin i derdhur por mungon elementi i lyer me bojë poliestër.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik "VASAA" SHPK qëndron pjesërisht.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes dhe rethanave të saj, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi analizoi pretendimet e ankimuesit të parashtruara në ankesë, pasi u konsultua me dispozitat e ligjit nr. 162, date 23.12.2020, "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe VKM-së nr.285, date 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, gjykon se pretendimet e subjektit ankimues qëndrojnë pjesërisht, pasi nuk gjejnë mbështetje në fakte, në prova, në ligjin nr. 162, date 23.12.2020. "Për Prokurimin Publik", në VKM nr.285, datë 19.05.2021. "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe në DST.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 114, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik", dhe nenit 102, germa "b" të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës,

Vendos:

5. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "VASAA" SHPK. Për procedurën e prokurimit publik me objekt "Blerje materiale elektrike për sistemin e ndriçimit rrugor dhe aksesore (shtylla ndriçimi, krahë një degëshe etj)", me nr. REF-62824-09-26-2025, me fond limit 12 948 800 (dymbëdhjetë milion e nëntëqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind) leke pa TVSH, zhvilluar në datë 14.10.2025, nga Autoriteti Kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier.
6. Autoriteti Kontraktor të njoftojë subjektin ankimues, subjektet e interesuara dhe KPP, duke i komunikuar me shkrim këtë vendim, në përputhje me rregullat e prokurimit dhe Udhëzimet e APP-së.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë."

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga ana e operatorëve ekonomikë të interesuar “*Ervin Luzi*” Person fizik, “*ZEQIRI*” SHPK dhe “*GENERAL TRADING*” SHPK, në përputhje me parashikimet e nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*VASAA*” SHPK, mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit, si në vijim: “*2- Referuar Shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.1, përcaktohet se: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Në kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se 4 000 000 lekë pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.*

Nga kqyrja e dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik, KVO konstatoi se: Subjekti paraqet ne sistem Vertetim me nr 231 prot date 12.02.2025, per pune te ngjashme te kryera ne Bashkine Lushnje me vlere 4 495 512 leke me TVSH. Nga perlllogaritjet e kryera vlera pa TVSH e kesaj kontrate eshte 3 746 260 lek. Pra vertetimi i paraqitur nuk e ploteson kushtin e kerkuarne SPE.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 14.10.2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt-ankimi.

III.1.2. Më datë 28.10.2025 autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin e ofertave si vijon:

1	“ <i>Ervin Luzi</i> ” P.F	8.785.000 leke	skualifikuar
2	“ <i>ZEQIRI</i> ” SHPK	9.280.000 leke	skualifikuar
3	“ <i>General Trading</i> ” SHPK	10.092.000 leke	skualifikuar
4	“ <i>VASAA</i> ” SHPK	10.601.000 leke	skualifikuar
5	“ <i>Sark</i> ” SHPK	10.675.000 leke	skualifikuar
6	“ <i>Modeste</i> ” SHPK	12.387.000 leke	skualifikuar
7	“ <i>Arteo 2018</i> ” SHPK	12.595.000 leke	skualifikuar
8	“ <i>Kalia</i> ” SHPK	12.916.500 leke	skualifikuar
9	“ <i>Hest</i> ” SHPK	12.917.500 leke	skualifikuar

III.1.3. Në datën 28.10.2025, operatori ekonomik “VASAA” ShPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës “VASAA” SHPK. me NUIS J62903470T, konstatoi mangësitë si më poshtë:

1- Referuar Shtojcës 8, në pikën 1.a kerkohet që operatori ekonomik të paraqesë “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;”. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton që operatori ekonomik nuk e ka ngarkuar këtë formular në përmbushje të këtij kriteri.

2- Referuar Shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.1, përcaktohet se: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Në këtë rast vlera e kerkuar është jo më pak se 4 000 000 lekë pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Nga kqyrja e dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik, KVO konstatoi se: Subjekti paraqet në sistem Vertetim me nr 231 prot date 12.02.2025, për punë të ngjashme të kryera në Bashkinë Lushnjë me vlerë 4 495 512 leke me TVSH. Nga përlllogaritjet e kryera vlera pa TVSH e kësaj kontrate është 3 746 260 lek. Pra vertetimi i paraqitur nuk e plotëson kushtin e kerkuar në SPE.

3- Referuar Shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.2, përcaktohet se:

“Ofertuesi duhet të paraqesë katalog/katalogje ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për zerat e mallrave sipas tabelës së mëposhtme, me të dhënat teknike, ku të jenë të përcaktuara zerat e mallrave dhe specifikimet teknike të tyre. Në katalog/katalogje duhet të markohet produkti që ofrohet. Emertimet e mallrave në tabelën e mëposhtme për të cilat duhet të paraqiten katalogë, i perkasin zerave 4 dhe 5 të preventivit të Shtojcës nr.7” Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” në DST. [Nëse materiali /et të cilat do të paraqiten për të përbushur kriterin e mësipërm janë në gjuhë të huaj, ato duhet të përkthehen në shqip për pjesën e të dhënave teknike të kerkuara si dhe të noterizuara].

Tabela me zerat e mallrave për të cilat duhet të paraqiten katalogë:

Nr. Emertimi i mallrave

4 Ndricues rrugor LED 100 W

5 Ndricues rrugor LED 150 W

Në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik, ka ngarkuar në SPE “Fragment katalogu» i cili nuk është i perkthyer

Referuar kërkesave ligjore për prokurimin publik, e pasqyruar edhe në DST, përcaktohet se:

”Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe.” Referuar njoftimit të kontratës, në Seksioni 4: Procedura, pika 4.7 “Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat” është zgjedhur opsioni “shqip”.

KVO, pasi kaqyri fragmentët e katalogëve të mësipërm, konstatoi se:

Për zërin me nr. Rendor 4 “Ndricues rrugor LED 100 Ë”:

- nuk gjen pasqyrim informacioni “Mbulesa e siperme polipropilen i perforcuar”.*
- nuk gjenë pasqyrim informacioni “Trupi i ndricuesit alumin i derdhur dhe i lyer me boje poliester”.*

Për zërin me nr. Rendor 5 “Ndricues rrugor LED 150 Ë”:

- nuk gjenë pasqyrim “Mbulesa e siperme polipropilen i perforcuar”.*
- nuk gjenë pasqyrim “Trupi i ndricuesit alumin i derdhur dhe i lyer me boje poliester”*

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 80, nenit 92/3 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 79, nenit 80, nenit 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, e shpall të pavlefshme këtë ofertë, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, duke e skulifikuar atë.”.

III.1.4. Më datë 29.10.2025, autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2025/6045, datë 04.11.2025 dhe me numër protokolli nr. 3147/2025, datë 04.11.2025 e operatorit ekonomik “VASAA” ShPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62824-09-26-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike per sistemin e ndricimit rrugor dhe aksesore (shtylla ndriçimi,krahe një degshe etj)”, me fond limit 12,948,800 (dymbëdhjete milion e nenteqind e dyzet e tete mije e teteqind) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 14.10.2025, nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, konstatohet se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “VASAA” SHPK.

Gjithashtu operatori ekonomik “VASAA” SHPK, kërkon mbetjen të skualifikuar të oferave të paraqitura nga operatorë ekonomikë “Ervin Luzi” Person fizik, “ZEQIRI” SHPK dhe GENERAL TRADING” SHPK në këtë procedurë prokurimi.

III.1.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit me Nr. 3147/1 Prot datë 05.11.2025, në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “VASAA” ShPK, si dhe mbetjen të skualifikuar të oferave të paraqitura nga operatorë ekonomikë “Ervin Luzi” Person fizik, “ZEQIRI” SHPK dhe GENERAL TRADING” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.7. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier ka dërguar shkresën nr. 795/12 prot, datë 10.11.2025 “Dërgohet vendimi i KSHA në lidhje me ankesën për vlerësimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale elektrike per sistemin e ndricimit rrugor dhe aksesore (shtylla ndriçimi,krahe një degshe etj)”, me nr. REF-62824-09-26-2025”, protokolluar me tonën me nr. 3147/2 prot, datë 10.11.2025, ku informon Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “VASAA” ShPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës me vendimin nr. 795/11 prot, datë 10.11.2025, e ka pranuar pjesërisht ankesën e ankimuesit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

Referuar formularit të ankesës së bërë nga operatori ekonomik "VASAA" SHPK, subjekt ankimues, pretendon se:

“Nuk është e vërtetë që Firma VASAA shpk, nuk ka ngarkuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas pikës 1/a të shtojcës 8, pasi Firma VISAA shpk ka ngarkuar në SPE Ekstrakrin Historik i Regjistrir Tregtar dhe Ekstraktin e Regiistrir Tregtar shharkuar elektronikisht nga Platforma E-albania, me vulë elektronike nga Baza e të Dhënave të regjistrir të të dhënave të bizneseve QKB... Kështu që AK e ka aksesin për verifikim automatik dhe mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në bazën e të dhënave të platformës E-albania për Firma VASAA. Pra ky pretendim i AK-së nuk qëndron.”.

Nga shqyrtimi i të gjithë dokumentave të vëna në dispozicion nga Njësia e Prokurimit. dokumentave të hedhura në sistem prej operatorit ekonomik, si dhe çdo dokument tjetër të nevojshem të dosjes së tenderit. konstatoi se:

Referuar Procesverbalit nr. 3. "Mbi shvillimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të tenderit "E hapur e thjeshtuar", me mjete elektronike -me objekt: "Blerje mareriale elekirike peer

sistemin e ndriçimit rrugor dhe aksesorë (shtylla ndriçimi, krahë një degshe etj" . nr. 795/5 Prot., datë 28.10.2025, mbajtur nga KVO, është pasqyruar një ndër arsyet e skualifikimit si më poshtë:

"Referuar Shtojcës 8, në pikën 1/a kërkohet që operatori ekonomik të paraqesë "Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;". Nga verifikimi dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton që operatori ekonomik nuk e ka ngarkuar këtë formular në përmbushje të këtij kriteri. "

Pra, nga arsyeja e skualifikimit të KVO vërehet se operatori është skualifikuar për mungesë të paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. sipas shtojcës 8 të DST-se.

Këtë fakt KSHA e ka konstatuar dhe në dokumentat e hedhura në sistem prej operatorit ekonomik. nga aksesimi i krijuar në llogari si hetues. Çdo dokument i kërkuar në DST duhet të paraqitet nga operatori ekonomik në mënyrë që kriteri të cilësohet i përmbushur. Paraqitja e ekstraktit historik të regjistrimit tregtar dhe ekstrakti i regjistrimit tregtar nuk plotësojnë kushtin e paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit në kushtet kur nuk është i njëjti dokument.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik VASAA" SHPK nuk qëndron.

Gjithashtu, referuar Formularit të Ankesës, Operatori ekonomik "VASAA" SHPK , pretendon se: "Operatoti Ekonomik sipas shtojcës 8, kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik pika 2.3.1 duhet të paraqesë dëshmi për realizim me sukses të një ose disa kontratave të ngjashme të realizuar gjatë 3 viteve të fundit me vlerë 4 000 000 leke, operatori ka paraqitur kontratë të ngjashme me vlerë 3.746.260 leke realizuar me Bashkinë Lushnje. Ky pretendim nuk është i vërtetë, past firma VASAA shpk, përveç Kontrateës me vërtetimin përkatës që ka realizuar me Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike Lushnje me vlerë 3.746.260 leke, ka hedhur në SPE dhe një kontratë të realizuar me Bashkinë Divjakë me vlerë 4.798.720 leke pa tvsh. Të dyja këto Kontrata kanë Vlerë 8.544.980 leke pa tvsh, pra është më e madhe se vlera 4.000.000 leke, që AK ka vendosur tek kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3.1 Pra pretendimi i AK-së nuk qëndron."

Sa më sipër, pretenduar KSHA aksesoi dokumentat e hedhura në sistem prej operatorit ekonomik, nga aksesimi i krijuar në llogari si hetues dhe konstaton se OE ka paraqitur në SPE:

- *Kontratë publike me Bashkinë Lushnje, nr.1392/4 prot, datë 12.12.2024 me objekt: "Blerje materiale elektrite për nevojat e NPP (koka ndriçimi LED dhe kablllo elektrike)", bashkëlidhur se cilës ka paraqitur, faturë shitje nr.589 datë 16.12.2024, faturë shitje nr.608 datë 23.12.2024, faturë shitje nr.609 datë 27.12.2024 dhe Vërtetim realizimi nr. 231 prot, datë 12.02.2025 me vlerë 3,746,260 pa TVSH.*

- Kontratë publike me Bashkinë Divjakë, nr.866/12 prot, datë 31.03.2023 me objekt: "Blerje transformatori dhe pajisje mbrojtje për gabinën elektrike godina e Bashkisë si edhe materiale elektrike për ndriçimin e rrugëve", bashkëlidhur së cilës ka paraqitur, faturë shitje nr. 270 datë 11.04.2023, faturë shitje nr.314 datë 27.04.2023, dhe Vërtetim për realizimin e kontratës nr. 6758/1 prot, datë 19.12.2023 me vlerë 4,798,720 pa TVSH.

Pas këtij verifikimi KSHA konstaton se OE e ka përmbushur kriterin teknik pika 2.3.1 të DST-së.
Për këto arsye, pretendimi i subjektit ankimues qëndronë.

Referuar formularit të ankesës së bërë nga operatori ekonomik "VASAA" SHPK, subjekti "..... Firma VASAA shpk, ka hedhur në SPE Katalogun LED STRET LIGHT, nga Kompania KAYHIN. nga e cila ka hedhur në SPE Autorizim Prodhuesi të përkthyer dhe noterizuar në giuhën shqipe. Ka hedhur Fragment katalogu, faqja nr 11 e katalogut, (bashkangjitur) për artikujt Nr 4. Ndriçues rrugor Led 100, Nr 5 Ndriçues rrugor Led 150Ë. Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar tek Kërkesat e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik 2.3.2 SKEDË TEKNIKE. për dy zërat e produkteve me formatin e skedës teknike, por ka kërkuar vetëm katalogë ose fragmente katalogu ku duhet të markohet produkti që ofrohet. Firma VASAA shpk, ka hedhur në SPE fragment katalogu fuqja 11 e katalogut LED STRET LIGHT të kompanise KAHIN, ku janë markuar: Ndriçues rrugor led 100ë, artikulli nr 4 i kërkuar; dhe ndriçues rrugor led 150ë, artikulli nr 5 i kërkuar (bashkangjitur)

Ndriçuesat e kërkuar	Ndriçuesat e Ofruar
Artikulli 4	Artikulli 4
Ndriçues Led 100w	Ndriçues Led 100w
Ac 85-265w	Ac 85-265w
IP 60	IP 65 (me shkallë më të lartë izolacioni)
10100 LM	12000 LM (me fluks më të lartë ndriçimi)
6000 K	6500 K (me ndriçim më të plotë)

Ndriçuesat e kërkuar	Ndriçuesat e Ofruar
Artikulli 5	Artikulli nr
Ndriçues Led 150w	Ndriçues Led 150w
Ac 85-265w	Ac 85-265w
IP 60	IP 65 (me shkallë më të lartë izolacioni)

15000 LM	18000 LM (me fluks më të lartë ndriçimi
6000 K	6500 K (me ndriçim më të plotë)

Gjuha e fragment katalogut faqja nr 11, është gjuhë teknike, si në shqip dhe anglisht ka të njëjtat terma teknike, dhe në çdo katalog të të gjitha kompanive ndërkombëtare të prodhimit të Ndriçuesave rrugor Led këto janë terma standarte të institucioneve të certifikuara për të përcaktuar parametrat e ndriçuesave rrugor led sipas standarteve: EN 60598-1, EN 60529, EN 62722-2-1 Pra pretendimi i AK-së nuk qëndron."

Sa më sipër, pretenduar KSHA konstaton se referuar kërkesave ligjore për prokurimin publik. e pasqyruar edhe në DST përcaktohet se:

"Oferta, si dhe të gjithë korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës.

Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe."

Referuar njoftimit të kontratës, në Seksioni 4: Procedura, pika 4.7 "Gjuha (ëi) në të cilat mund të hartohen ofertat" është zgjedhur opsioni "shqip"

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik "VASAA" SHPK nuk qëndron.

* * *

Referuar formularit të ankesës së bërë nga operatori ekonomik "VASAA" SHPK, subjekti ankimues, pretendon se:

"Për serinë e mallrave me numër rendor 4.Ndriçues rrugor Led 100w, dhe numër rendor 5. Ndriçues Rrugor Led 150w nuk gjen pasqyrim informacioni mbulesa e sipërme polipropilen i përforcuar, trupi i ndriçuesit alumin i derdhur dhe i lyer me bojë polyester...

.... Firma VASAA shpk, ka një experiencë shumë të gjatë 30 vjeçare në fushën e tregtimit të materialeve të ndriçimit, materialeve elektrike, dhe në veçanti të materialeve të ndriçimit rrugor; me dy Inxhinier Elektrik të përfshirë në stafin e saj prej një kohe shumë të gjatë, me përvoja të suksesshme në tregtimin dhe zbatimin e tyre në tregun privat dhe public. Në bazë të kësaj experience ndriçuesat që janë ofruar në procedurën në fjalë janë me parametra më të mirë sesa ndriçuesat e kërkuar nga AK-ja ,dhe konkretisht :

-Me trup alumin i derdhur me IP 65 nivelin e mbrojtjes që ofron trupi i ndriçuesit LED ndaj kushteve atmosferike të pluhurit dhe ujit, me shkallë më të lartë izolacioni se sa e ka kërkuar AK-ja IP60, standarti EN 60598-1 / EN 60529 (IP65). Nuk e di ku e ka gjetur AK-ja shkallën e izolacionit IP60 ?, se nuk egziston

-Me Klas IK08 që është e rëndësishme, pasi ndriçuesi siguron një qëndrueshmëri të lartë ndaj goditjeve mekanike në ambjente publike të jashtme, standarti EN 62262 të cilën AK-ja nuk e ka kërkuar fare.

-Me Mbulesë Polipropilen që siguron një shpërndarje uniforme të dritës, standarti EN 60598-1

-Me qëndrueshmëri të trupit alumini dhe cast të ndriçuesit dhe jetëgjatësi

-Me Guarnicion të gomuar Kundër Ujit standarti EN 60529 që nuk lejon lagështirën të hyjë në trupin e ndriçuesit.(bashkangjitur fragmenti i katalogut)

Pra Pretendimi i AK-së nuk qëndron".

Sa më sipër, pretenduar KSHA konstaton se referuar specifikimeve teknike kërkuar nga AK, shkalla e izolacionit është për grupin optik **min IP 60** dhe jo IP 60.

Gjithashtu referuar specifikimeve teknike të AK dhe fragmentit të katalogut të OE, specifikimi "mbulesë me propilen" nuk gjen pasqyrim në katalog, ndërsa përsa i përket "trupit të ndriçuesit i derdhur dhe i lyer me bojë poliestër" sipas katalogut të OE trupi i ndriçuesit është alumin i derdhur por mungon elementi i lyer me bojë poliestër.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik "VASAA" SHPK qëndron pjesërisht.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes dhe rethanave të saj, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi analizoi pretendimet e ankimuesit të parashtruara në ankesë, pasi u konsultua me dispozitat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, gjykon se pretendimet e subjektit ankimues qëndrojnë pjesërisht, pasi nuk gjejnë mbështetje në fakte, në prova, në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020. "Për Prokurimin Publik", në VKM nr.285, datë 19.05.2021. "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe në DST.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 114, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik", dhe nenit 102, germa "b" të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës,

Vendos:

9. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "VASAA" SHPK. Për procedurën e prokurimit publik me objekt "Blerje materiale elektrike për sistemin e ndriçimit rrugor dhe aksesore (shtylla ndriçimi, krahë një degëshe etj)", me nr. REF-62824-09-26-2025, me fond limit 12 948 800 (dymbëdhjetë milion e nëntëqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind) leke pa TVSH, zhvilluar në datë 14.10.2025, nga Autoriteti Kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier.
10. Autoriteti Kontraktor të njoftojë subjektin ankimues, subjektet e interesuara dhe KPP, duke i komunikuar me shkrim këtë vendim, në përputhje me rregullat e prokurimit dhe Udhëzimet e APP-së.
11. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik.

12. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”.

III.1.8. Me shkresën nr. 795/12 prot, datë 10.11.2025 “Dërgohet vendimi i KSHA në lidhje me ankesën për vlerësimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale elektrike për sistemin e ndricimit rrugor dhe aksesore (shtylla ndriçimi,krahe një degshe etj)”, me nr. REF-62824-09-26-2025”, protokolluar me tonën me nr. 3147/3 prot, datë 12.11.2025, autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “VASSA” ShPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës me vendimin nr. 795/11 prot, datë 10.11.2025, e ka pranuar pjesërisht ankesën e ankimuesit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

Referuar formularit të ankesës së bërë nga operatori ekonomik "VASAA" SHPK, subjekt ankimues, pretendon se: “Nuk është e vërtetë që Firma VASAA shpk, nuk ka ngarkuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas pikës 1/a të shtojcës 8, pasi Firma VISAA shpk ka ngarkuar në SPE Ekstraksin Historik i Regjistrimit Tregtar dhe Ekstraksin e Regjistrimit Tregtar shharkuar elektronikisht nga Platforma E-albania, me vulë elektronike nga Baza e të Dhënave të regjistrimit të të dhënave të bizneseve QKB... Kështu që AK e ka aksesin për verifikim automatik dhe mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në bazën e të dhënave të platformës E-albania për Firma VASAA. Pra ky pretendim i AK-së nuk qëndron.”.

Nga shqyrtimi i të gjithë dokumentave të vëna në dispozicion nga Njësia e Prokurimit. dokumentave të hedhura në sistem prej operatorit ekonomik, si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm të dosjes së tenderit. konstatoi se:

Referuar Procesverbalit nr. 3. "Mbi shvillimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të tenderit "E hapur e thjeshtuar", me mjete elektronike -me objekt: "Blerje materiale elektrike për sistemin e ndriçimit rrugor dhe aksesore (shtylla ndriçimi,krahë një degshe etj)”. nr. 795/5 Prot., datë 28.10.2025, mbajtur nga KVO, është pasqyruar një ndër arsyet e skualifikimit si më poshtë:

“Referuar Shtojcës 8, në pikën 1/a kërkohet që operatori ekonomik të paraqesë "Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;". Nga verifikimi dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton që operatori ekonomik nuk e ka ngarkuar këtë formular në përmbushje të këtij kriteri. "

Pra, nga arsyeja e skualifikimit të KVO vërehet se operatori është skualifikuar për mungesë të paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. sipas shtojcës 8 të DST-se.

Këtë fakt KSHA e ka konstatuar dhe në dokumentat e hedhura në sistem prej operatorit ekonomik. nga aksesimi i krijuar në llogari si hetues. Çdo dokument i kërkuar në DST duhet të paraqitet nga operatori ekonomik në mënyrë që kriteri të cilësohet i përmbushur. Paraqitja e

ekstraktit historik të regjistrit tregtar dhe ekstrakti i regjistrit tregtar nuk plotësojnë kushtin e paraqitjes së formularit përmbledhes të vetëdeklarimit në kushtet kur nuk është i njëjti dokument.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik VASAA" SHPK nuk qëndron.

Gjithashtu, referuar Formularit të Ankesës, Operatori ekonomik "VASAA" SHPK , pretendon se: "Operatoti Ekonomik sipas shtojcës 8, kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik pika 2.3.1 duhet të paraqesë dëshmi për realizim me sukses të një ose disa kontratave të ngjajshme të realizuar gjatë 3 viteve të fundit me vlerë 4 000 000 leke, operatori ka paraqitur kontratë të ngjashme me vlerë 3.746.260 leke realizuar me Bashkinë Lushnje. Ky pretendim nuk është i vërtetë, past firma VASAA shpk, përveç Kontrateës me vërtetimin përkatës që ka realizuar me Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike Lushnje me vlerë 3.746.260 leke, ka hedhur në SPE dhe një kontratë të realizuar me Bashkinë Divjakë me vlerë 4.798.720 leke pa tvsh. Të dyja këto Kontrata kanë Vlerë 8.544.980 leke pa tvsh, pra është më e madhe se vlera 4.000.000 leke, që AK ka vendosur tek kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3.1 Pra pretendimi i AK-së nuk qëndron."

Sa më sipër, pretenduar KSHA aksesoi dokumentat e hedhura në sistem prej operatorit ekonomik, nga akses i krijuar në llogari si hetues dhe konstaton se OE ka paraqitur në SPE:

- Kontratë publike me Bashkinë Lushnje, nr.1392/4 prot, datë 12.12.2024 me objekt: "Blerje materiale elektrite për nevojat e NPP (koka ndriçimi LED dhe kablllo elektrike)", bashkëlidhur se cilës ka paraqitur, faturë shitje nr.589 datë 16.12.2024, faturë shitje nr.608 datë 23.12.2024, faturë shitje nr.609 datë 27.12.2024 dhe Vërtetim realizimi nr. 231 prot, datë 12.02.2025 me vlerë 3,746,260 pa TVSH.
- Kontratë publike me Bashkinë Divjakë, nr.866/12 prot, datë 31.03.2023 me objekt: "Blerje transformatori dhe pajisje mbrojtje për gabinën elektrike godina e Bashkisë si edhe materiale elektrike për ndriçimin e rrugëve", bashkëlidhur së cilës ka paraqitur, faturë shitje nr. 270 datë 11.04.2023, faturë shitje nr.314 datë 27.04.2023, dhe Vërtetim për realizimin e kontratës nr. 6758/1 prot, datë 19.12.2023 me vlerë 4,798,720 pa TVSH.

Pas këtij verifikimi KSHA konstaton se OE e ka përmbushur kriterin teknik pika 2.3.1 të DST-së.

Për këto arsye, pretendimi i subjektit ankimes qëndronë.

Referuar formularit të ankesës së bërë nga operatori ekonomik "VASAA" SHPK, subjekti "..... Firma VASAA shpk, ka hedhur në SPE Katalogun LED STRET LIGHT, nga Kompania KAYHIN. nga e cila ka hedhur në SPE Autorizim Prodhuesi të përkthyer dhe noterizuar në giuhën shqipe. Ka hedhur Fragment katalogu, faqja nr 11 e katalogut, (bashkangjitur) për artikujt Nr 4. Ndriçues rrugor Led 100, Nr 5 Ndriçues rrugor Led 150Ë. Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar

tek Kërkesat e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik 2.3.2 SKEDË TEKNIKE. për dy zërat e produkteve me formatin e skedës teknike, por ka kërkuar vetëm katalogë ose fragmente katalogu ku duhet të markohet produkti që ofrohet. Firma VASAA shpk, ka hedhur në SPE fragment katalogu faqja 11 e katalogut LED STRET LIGHT të kompanisë KAHIN, ku janë markuar: Ndriçues rrugor led 100ë, artikulli nr 4 i kërkuar; dhe ndriçues rrugor led 150ë, artikulli nr 5 i kërkuar (bashkangjitur)

Ndriçuesat e kërkuar	Ndriçuesat e Ofruar
Artikulli 4	Artikulli 4
Ndriçues Led 100w	Ndriçues Led 100w
Ac 85-265w	Ac 85-265w
IP 60	IP 65 (me shkallë më të lartë izolacioni)
10100 LM	12000 LM (me fluks më të lartë ndriçimi)
6000 K	6500 K (me ndriçim më të plotë)

Ndriçuesat e kërkuar	Ndriçuesat e Ofruar
Artikulli 5	Artikulli nr
Ndriçues Led 150w	Ndriçues Led 150w
Ac 85-265w	Ac 85-265w
IP 60	IP 65 (me shkallë më të lartë izolacioni)
15000 LM	18000 LM (me fluks më të lartë ndriçimi)
6000 K	6500 K (me ndriçim më të plotë)

Gjuha e fragment katalogut faqja nr 11, është gjuhë teknike, si në shqip dhe anglisht ka të njëjtat terma teknike, dhe në çdo katalog të të gjitha kompanive ndërkombëtare të prodhimit të Ndriçuesave rrugor Led këto janë terma standarte të institucioneve të certifikuara për të përcaktuar parametrat e ndriçuesave rrugor led sipas standarteve: EN 60598-1, EN 60529, EN 62722-2-1 Pra pretendimi i AK-së nuk qëndron."

Sa më sipër, pretenduar KSHA konstaton se referuar kërkesave ligjore për prokurimin publik. e pasqyruar edhe në DST përcaktohet se:

"Oferta, si dhe të gjithë korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës.

Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe."

Referuar njoftimit të kontratës, në Seksioni 4: Procedura, pika 4.7 "Gjuha (ëi) në të cilat mund të hartohen ofertat" është zgjedhur opsioni "shqip"

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik "VASAA" SHPK nuk qëndron.

* * *

Referuar formularit të ankesës së bërë nga operatori ekonomik "VASAA" SHPK, subjekti ankimues, pretendon se:

"Për serinë e mallrave me numër rendor 4.Ndriçues rrugor Led 100ë, dhe numër rendor 5. Ndriçues Rrugor Led 150ë nuk gjen pasqyrim informacioni mbulesa e sipërme polipropilen i përforcuar, trupi i ndriçuesit alumin i derdhur dhe i lyer me bojë polyester...

.... Firma VASAA shpk, ka një experiencë shumë të gjatë 30 vjeçare në fushën e tregtimit të materialeve të ndriçimit, materialeve elektrike, dhe në veçanti të materialeve të ndriçimit rrugor; me dy Inxhinier Elektrik të përfshirë në stafin e saj prej një kohe shumë të gjatë, me përvoja të suksesshme në tregtimin dhe zbatimin e tyre në tregun privat dhe public. Në bazë të kësaj experience ndriçuesat që janë ofruar në procedurën në fjalë janë me parametra më të mirë sesa ndriçuesat e kërkuar nga AK-ja ,dhe konkretisht :

-Me trup alumin i të derdhur me IP 65 nivelin e mbrojtjes që ofron trupi i ndriçuesit LED ndaj kushteve atmosferike të pluhurit dhe ujit, me shkallë më të lartë izolacioni se sa e ka kërkuar AK-ja IP60, standarti EN 60598-1 / EN 60529 (IP65). Nuk e di ku e ka gjetur AK-ja shkallën e izolacionit IP60 ?, se nuk egziston

-Me Klas IK08 që është e rëndësishme, pasi ndriçuesi siguron një qëndrueshmëri të lartë ndaj goditjeve mekanike në ambiente publike të jashtme, standarti EN 62262 të cilën AK-ja nuk e ka kërkuar fare.

-Me Mbulesë Polipropilen që siguron një shpërndarje uniforme të dritës, standarti EN 60598-1

-Me qëndrueshmëri të trupit alumin dhe cast të ndriçuesit dhe jetëgjatësi

-Me Guarnicion të gomuar Kundër Ujit standarti EN 60529 që nuk lejon lagështirën të hyjë në trupin e ndriçuesit.(bashkangjitur fragmenti i katalogut)

Pra Pretendimi i AK-së nuk qëndron".

Sa më sipër, pretenduar KSHA konstaton se referuar specifikimeve teknike kërkuar nga AK, shkalla e izolacionit është për grupin optik **min IP 60** dhe jo IP 60.

Gjithashtu referuar specifikimeve teknike të AK dhe fragmentit të katalogut të OE, specifikimi "mbulesë me propilen" nuk gjen pasqyrim në katalog, ndërsa përvoja i përket "trupit të ndriçuesit

i derdhur dhe i lyer me bojë poliestër" sipas katalogut të OE trupi i ndriçuesit është alumin i derdhur por mungon elementi i lyer me bojë poliestër.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik "VASAA" SHPK qëndron pjesërisht.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes dhe rethanave të saj, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi analizoi pretendimet e ankimuesit të parashtruara në ankesë, pasi u konsultua me dispozitat e ligjit nr. 162, date 23.12.2020, "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe VKM-së nr.285, date 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, gjykon se pretendimet e subjektit ankimues qëndrojnë pjesërisht, pasi nuk gjejnë mbështetje në fakte, në prova, në ligjin nr. 162, date 23.12.2020. "Për Prokurimin Publik", në VKM nr.285, datë 19.05.2021. "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe në DST.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 114, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik", dhe nenit 102, germa "b" të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës,

Vendos:

- 13. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "VASAA" SHPK. Për procedurën e prokurimit publik me objekt "Blerje materiale elektrike për sistemin e ndriçimit rrugor dhe aksesore (shtylla ndriçimi, krahë një degëshe etj)", me nr. REF-62824-09-26-2025, me fond limit 12 948 800 (dymbëdhjetë milion e nëntëqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind) leke pa TVSH, zhvilluar në datë 14.10.2025, nga Autoriteti Kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier.*
- 14. Autoriteti Kontraktor të njoftojë subjektin ankimues, subjektet e interesuara dhe KPP, duke i komunikuar me shkrim këtë vendim, në përputhje me rregullat e prokurimit dhe Udhëzimet e APP-së.*
- 15. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik.*
- 16. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë."*

III.1.9. Neni 30, e ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se:

"1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik.

2. Vendimet e marra nga Komisioni janë administrativisht përfundimtare. Këto vendime mund të ankimohen në Gjykatën Administrative të Apelit, në përputhje me nenin 121 të këtij ligji.
3. Në përfundim të shqyrtimit, vendimi i marrë nga Komisioni, përveç palëve në proces u bëhet i njohur edhe subjekteve të tjera që preken nga ky vendim, si edhe publikohet në faqen e internetit të këtij institucioni brenda 2 ditëve nga dalja e tij.
4. Askush nuk duhet të ndikojë mbi anëtarët e komisionit në vendimmarrje. Çdo përpjekje e drejtpërdrejtë ose e tërthortë për të ndikuar dënohet me gjobë, sipas këtij ligji, pavarësisht procedimit civil apo penal që mund të ketë filluar.
5. Rregullat e hollësishme të organizimit dhe të funksionimit të Komisionit të Prokurimit Publik miratohen nga vetë Komisioni me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.”.

III.1.10. Neni 115, pika 1 dhe 2, e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se:

“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”.

III.1.11. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues në lidhje me arsyen e skualifikimit të ofertës së dorëzuar prej tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, si në vijim: “2- Referuar Shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.1, përcaktohet se: Operatori ekonomik

duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se 4 000 000 lekë pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Nga kqyrja e dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik, KVO konstatoi se: Subjekti paraqet ne sistem Vertetim me nr 231 prot date 12.02.2025, per pune te ngjashme te kryera ne Bashkine Lushnje me vlere 4 495 512 leke me TVSH. Nga perlllogaritjet e kryera vlera pa TVSH e kesaj kontrate eshte 3 746 260 lek. Pra vertetimi i paraqitur nuk e ploteson kushtin e kerkuarne SPE.”, rezultojnë që të jëtë pranuar plotësisht nga autoriteti kontraktor përsa i përket plotësimi të kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ndaj dhe Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës bazuar në nenin 115 të LPP-së dhe do të vazhdojë shqyrtimin në themel për pjesën tjetër të saj.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “VASAA” SHPK, mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit, si në vijim: “1- Referuar Shtojcës 8, ne piken 1.a kerkohet qe operatori ekonomik te paraqese “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;”. Nga verifikimi i dokumentacionit te ngarkuar ne SPE rezulton qe operatori ekonomik nuk e ka ngarkuar kete formular ne permbushje te ketij kriteri.

”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në pikën 1 “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/SKUALIFIKIMIT” të Shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret e përgjithshme të kualifikimit, si më poshtë vijon:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT
OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);*
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;*
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;*

- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

III.2.2. Në pikën 1/a “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT” të Shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të Shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin e veçantë të kualifikimit, si më poshtë vijon:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

III.2.3. Në Shtojcës 9 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka publikuar formularin për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, si më poshtë vijon:

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----

E-mail:	-----
---------	-------

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

<i>Emri i nënkontraktorit të propozuar</i>	<i>NIPT –i</i>	<i>Përqindja e nënkontraktimit</i>	<i>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar</i>

- **Informacione për nënkontraktorin**

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<i>Emri (at) e subjekteve</i>	<i>NIPT-i</i>	<i>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</i>	<i>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</i>

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

*Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:***

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) çmimet;*
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;*
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,*
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.*

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të

Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje

<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</i> <i>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</i>	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.

- **Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.**

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- **Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.**
- **Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.**
- **Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara.**
- **Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.**

Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.2.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “VASAA” SHPK, për përmbushjen të kërkesës së mësipërme, rezulton se ky i fundit nuk ka paraqitur Shtojcën 9 “**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.2.5. Lidhur me pretendimet e parashtruara në ankesë nga ana e operatorit ekonomik “VASAA” SHPK, si në vijim: “Nuk është e vërtetë që Firma VASAA shpk, nuk ka ngarkuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas pikës 1/a të shtojcës 8, pasi Firma VISAA shpk ka ngarkuar në SPE Ekstraksin Historik i Regjistrimit Tregtar dhe Ekstraksin e Regjistrimit Tregtar shharkuar elektronikisht nga Platforma E-albania, me vulë elektronike nga Baza e të Dhënave të regjistrimit të të dhënave të bizneseve QKB... Kështu që AK e ka aksesin për verifikim automatik dhe mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në bazën e të dhënave të platformës E-albania për Firma VASAA. Pra ky pretendim i AK-së nuk qëndron.”, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pranë autoritetit kontraktor me vendimin nr. 795/11 prot, datë 10.11.2025, dërguar me shkresën nr. 795/12 prot, datë 10.11.2025 “Dërgohet vendimi i KSHA në lidhje me ankesën për vlerësimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale elektrike për sistemin e ndricimit rrugor dhe aksesore (shtylla ndriçimi, krahe një degshe etj)”, me nr. REF-62824-09-26-2025”, protokolluar me tonën me nr. 3147/3 prot, datë 12.11.2025, nuk e ka pranuar këtë

pretendim të ankimuesit, duke argumentuar si në vijim: “Nga shqyrtimi i të gjithë dokumentave të vëna në dispozicion nga Njësia e Prokurimit. dokumentave të hedhura në sistem prej operatorit ekonomik, si dhe çdo dokument tjetër të nevojshem të dosjes së tenderit. konstatoi se: Referuar Procesverbalit nr. 3. "Mbi shvillimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të tenderit "E hapur e thjeshtuar", me mjete elektronike -me objekt: "Blerje mareriale elekirike peer sistemin e ndriçimit rrugor dhe aksesore (shtylla ndriçimi,krahë një degshe etj” . nr. 795/5 Prot., datë 28.10.2025, mbajtur nga KVO, është pasqyruar një ndër arsytet e skualifikimit si më poshtë: “Referuar Shtojcës 8, në pikën l/a kërkohet që operatori ekonomik të paraqesë "Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;". Nga verifikimi dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton që operatori ekonomik nuk e ka ngarkuar këtë formular në përmbushje të këtij kriteri.”.

Pra, nga arsyeja e skualifikimit te KVO vërehet se operatori është skualifikuar për mungesë të paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. sipas shtojcës 8 të DST-se.

Këtë fakt KSHA e ka konstatuar dhe në dokumentat e hedhura në sistem prej operatorit ekonomik. nga aksesit i krijuar në llogari si hetues. Çdo dokument i kërkuar në DST duhet të paraqitet nga operatori ekonomik në mënyrë që kriteri të cilësohet i përmbushur. Paraqitja e ekstraktit historik të regjistrit tregtar dhe ekstrakti i regjistrit tregtar nuk plotësojnë kushtin e paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit në kushtet kur nuk është i njëjti dokument. **Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik VASAA" SHPK nuk qëndron.”.**

III.2.6. Në nenin 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se:

“1. Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij. Komisioni i Prokurimit Publik administron të dhënat e Sistemit të Ankesave Elektronike.”.

III.2.7. Në nenin 26 pika 6 paragrafi i parë të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimi publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në 16 shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

III.2.8. Në nenin 32 pika 1 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimi publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Menjëherë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen ose përfundohen në formë shkresore, autoriteti/enti kontraktor publikon njoftimin e fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike.”.

III.2.9. Në nenin 10 “Parimi i dhënies së ndihmës aktive” të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se:

“1. Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre.

2. Organi publik promovon mundësinë e palës për të aksesuar autoritetin publik në mënyrë elektronike. Kjo mundësi nuk është e lidhur me ndonjë detyrim të palës për të përdorur mjete të komunikimit elektronik.

3. Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që padija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që pala gëzon sipas ligjit.”.

III.2.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.11. Referuar dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi kërkohet paraqitja e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit në fazën e dorëzimit të ofertave për një sërë kriteresh të përcaktuara në shtojcën 8 të kriterëve të përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit. Në rastin konkret, nga verifikimi në SPE vihet re, se në përmbushje të kërkesës së mësipërme operatori ekonomik ankimues nuk ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik.

III.2.12. Referuar edhe parashtimeve në ankesë, ankimuesi pranon mungesën e dokumentit të kërkuar me pretendimin se ka pasur probleme me internetin. KPP gjykon se mungesa fizike e dokumentacionit të kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit, përbën shkak për skualifikim në kuptim të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, arsyeja e skualifikimi të operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor është e drejtë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “VASAA” shpk nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “VASAA” SHPK, mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit, si në vijim: “3- Referuar Shtojcës 8, *“Kriteret e veçanta të kualifikimit”*, *“Kapaciteti teknik”*, në pikën 2.3.2, përcaktohet se:

*“Ofertuesi duhet të paraqesë katalog/katalogje ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për zerat e mallrave sipas tabelës së mëposhtme, me të dhënat teknike, ku të jenë të përcaktuara zerat e mallrave dhe specifikimet teknike të tyre. Në katalog/katalogje duhet të markohet produkti që ofrohet. Emertimet e mallrave në tabelën e mëposhtme për të cilat duhet të paraqiten katalogë, i perkasin zerave 4 dhe 5 të preventivit të Shtojcës nr.7”*Formulari i sasisë dhe grafikut

të lëvrimit” në DST. [Nese materiali /et te cilat do te paraqiten per teper mbushur kriterin e mesiperm jane ne gjuhe te huaj, ato duhet te perkthehen ne shqip per pjesen e te dhenave teknike te kerkuara si dhe te noterizuara].

Tabela me zerat e mallrave per te cilat duhet te paraqiten katalogë:

Nr. Emertimi i mallrave

4 Ndricules rrugor LED 100 W

5 Ndricules rrugor LED 150 W

Në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik, ka ngarkuar në SPE “Fragment katalogu» i cili nuk është i perkthyer

Referuar kërkesave ligjore për prokurimin publik, e pasqyruar edhe në DST, përcaktohet se:

”Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe.” Referuar njoftimit të kontratës, në Seksioni 4: Procedura, pika 4.7 “Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat” është zgjedhur opsioni “shqip”.

KVO, pasi kaqyri fragmentët e katalogëve të mësipërm, konstatoi se:

Për zërin me nr. Rendor 4 “Ndricules rrugor LED 100 W”:

- nuk gjen pasqyrim informacioni “Mbulesa e siperme polipropilen i perforcuar”.
- nuk gjenë pasqyrim informacioni “Trupi i ndricuesit alumin i derdhur dhe i lyer me boje poliester”.

Për zërin me nr. Rendor 5 “Ndricules rrugor LED 150 W”:

- nuk gjenë pasqyrim “Mbulesa e siperme polipropilen i perforcuar”.
- nuk gjenë pasqyrim “Trupi i ndricuesit alumin i derdhur dhe i lyer me boje poliester”

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 80, nenit 92/3 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 79, nenit 80, nenit 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, e shpall të pavlefshme këtë ofertë, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, duke e skulifikuar atë.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në pikën 4.7 “Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar gjuhën e ofertës, si më poshtë vijon:

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip X

Anglisht

III.3.2. Në pikën 2.3.2 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 8 “**FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin e veçantë të kualifikimit, si më poshtë vijon:

2.3.2 Ofertuesi duhet të paraqesë katalog/katalogje ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për zerat e mallrave sipas tabelës së mëposhtme, me të dhënat teknike, ku të jenë të përcaktuara zerat e mallrave dhe specifikimet teknike të tyre. Në katalog/katalogje duhet të markohet produkti që ofrohet.

Emertimet e mallrave në tabelën e mëposhtme për të cilat duhet të paraqiten katalogë, i perkasin zerave 4 dhe 5 të preventivit të Shtojcës nr.7 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” në DST.

[Nëse materiali /et të cilat do të paraqiten për të përmbushur kriterin e mësipër janë në gjuhë të huaj, ato duhet të përkthehen në shqip për pjesën e të dhënave teknike të kërkuara si dhe të noterizuara].

Tabela me zerat e mallrave për të cilat duhet të paraqiten katalogë:

Nr.	Emertimi i mallrave
4	Ndricues rrugor LED 100 W
5	Ndricues rrugor LED 150 W

III.3.3. Në Shtojcës 6 “**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike të produkteve objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: *Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në*

raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

-Bashkelidhur DST ne SPE gjenden specifikimet teknike se bashku me fotot (modelet)/ skicat ilustruese (orientuese) ose ekuivalente te tyre.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Mallrat objekt prokurimi do të kolaudohen e merren në dorezim nga një komision i posaçëm i ngritur nga AK. Malli duhet të plotësojë të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, në të kundërt AK nuk do të marrë materialet në dorezim dhe do të kërkojë zëvendësimin e tyre derisa të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Në çmimin dhe vlerën e ofertes, përfshihen furnizimi, transporti i mallit objekt prokurimi, ambalazhimi, risqet dhe përgjegjësitë ndaj të tjerëve, si dhe të gjitha detyrimet apo kostot e tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar apo praktikën me të mira, deri në dorëzimin e tyre në destinacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Shenim: Referimet ku në specifikime, preventiv, dokumenta bashkelidhur DST ne SPE mund të jenë përmendur marka / produkte / origjinë, shoqërohen me fjalën “ose ekuivalente”.

Në dokumentin e emërtuar “specifikime teknike” të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), enti prokurues ka përcaktuar specifikimet teknike të kërkuara për atikujt objekt prokurimi me numër rendor nr. 4 “Ndricues rrugor LED 100 w” dhe me numër rendor nr. 5 “Ndricues rrugor LED 150 w”, si më poshtë vijon”

“4. Ndricues rrugor LED 100 w

Fuqia e llampes 100 W.Tipi i llampes LED

Shkalla e izolacionit : -per grupin optik min IP 60

Karakteristika konstruktive:

Mbulesa e siperme polipropilen i perforcuar

Trupi i ndricuesit alumin i derdhur dhe i lyer me boje poliester

Tensioni 85-265 V

Fluksi i ndricimit : min 10100 lm

Temperatura e ngjyrave min:6000 K

Prodhim i standarteve Shqiptare,ose evropiane ose ekuivalente me këto

5. Ndricues rrugor LED 150 w

Fuqia e llampes 150 W.Tipi i llampes LED

Shkalla e izolacionit : -per grupin optik min IP 60

Karakteristika konstruktive:

Mbulesa e sipërme polipropilen i perforcuar

Trupi i ndricuesit alumin i derdhur dhe i lyer me boje poliester

Tensioni 85-265 V

Fluksi i ndricimit min 15000 lm

Temperatura e ngjyrave min:6000K

Prodhim i standarteve Shqiptare,ose evropiane ose ekuivalente me këto”.

III.3.4. Në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur operatori ekonomik “VASSA” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Dokumentin e emërtuar “Fragment_katalogu”, të lëshuar nga kompania “XXXX”, në gjuhën angleze, të pa përkthyer dhe noterizuar.
- Dokumentin e emërtuar “LED_STREET_LIGHT__202503”, të lëshuar nga kompania “XXXX”, në gjuhën angleze, të pa përkthyer dhe noterizuar.

III.3.5. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.3.6. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.3.7. Në nenin 77, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.3.8. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvritimit të mallrave.

2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen

si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, 7 mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

9. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përllogaritur.”.

III.3.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që

nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.10. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në pikën 2.3.2 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 8 “**FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ka kërkuar shprehimisht që: [...] Ofertuesi duhet të paraqesë katalog/katalogje ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për zërat e mallrave sipas tabelës së wmeposhtme, me të dhënat teknike, ku të jenë të përcaktuar zërat e mallrave dhe specifikimet teknike të tyre. Në katalog/katalogje duhet të markohet produkti që ofrohet.
Emërtimet e mallrave në tabelën e mëposhtme për të cilat duhet të paraqiten katalogë, i përkasin zërave 4 dhe 5 të preventivit të Shtojcës nr.7 "Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit" në DST.

[Nëse materiali /et të cilat do të paraqiten për të përmbushur kriterin e mësipërm janë në gjuhë të huaj, ato duhet të përkthehen në shqip për pjesën e të dhënave teknike të kërkuara si dhe të noterizuar]. Tabela me zërat e mallrave për të cilat duhet të paraqiten katalogë:

<u>Nr.</u>	<u>Emërtimi i mallrave</u>
<u>4</u>	<u>Ndricues rrugor LED 100 W</u>
<u>5</u>	<u>Ndricues rrugor LED 150 W</u>

[...].

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “VASAA” SHPK në sistemin e prokurimeve elektronike për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.3.4. të këtij vendimi dhe konkretisht dokumentacionin si në vijim: “Dokumentin e emërtuar “Fragment_katalogu”, i lëshuar nga kompania “XXXX”, i pa përkthyer dhe i pa noterizuar dhe Dokumentin e emërtuar “LED_STREET_LIGHT_202503”, i lëshuar nga kompania “XXXX”, i pa përkthyer dhe i pa noterizuar.”.

Nisur nga arsyet e skualifikimit të sipërpërmendura dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues për mospërmbushjen e kriterit të parashikuar në pikën 2.3.2 përsa i përket paraqitjes së katalogëve apo skedave teknike të produkteve të ofruara të përkthyer, Komisioni pasi verifikoi dokumentacionin e ngarkuar në SPE nga ky operator ekonomik ofertues rezulton se ky ofertues ka paraqitur katalogë të produktet të kompanive prodhuese në gjuhë të huaj, por nuk ka paraqitur

katalogët e përkthyer dhe të noterizuar (*fakt i cili pranohet edhe vetë nga ankimuesi*), ndaj kërkesa e autoritetit kontraktor me dokumentacionin e ngarkuar në SPE nga ana e operatorit ekonomik “VASAA” SHPK, nuk përmbushet nga ana e këtij te fundit. Në këtë kuadër KPP gjykon, se arsyet e skualifikimit të dhëna nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për operatorin ekonomik ofertues “VASAA” SHPK qëndrojnë, pasi gjuha e prokurimit është gjuha shqipe dhe katalogët e paraqitur janë në gjuhë të huaj dhe të pashoqëruar më përkthim zyrtar në gjuhën shqipe. Sa më lart, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “VASAA” SHPK do të konsiderohet i parregullt, duke mosplotësuar kështu kriterin kualifikues të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.2 “*Kapaciteti teknik*” të Shtojcës 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “VASAA” SHPK nuk qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “VASAA” SHPK për mbetjen të skualifikuar të operatorëve ekonomikë “*Ervin Luzi*” Person fizik, “*ZEQIRI*” SHPK dhe “*GENERAL TRADING*” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i këtyre shoqërive është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 28.10.2025, ku këto shoqëri rezultojnë të skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezulton që këta operatorë ekonomikë të jetë ankimuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik “VASAA” SHPK mbi shoqëritë “*Ervin Luzi*” Person fizik, “*ZEQIRI*” SHPK dhe “*GENERAL TRADING*” SHPK nuk do të merret në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “VASAA” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62824-09-26-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike për sistemin e ndricimit rrugor dhe aksesore (shtylla ndriçimi, krahe një degshe etj)”, me fond limit 12,948,800 (dymbëdhjetë milion e nentëqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 14.10.2025, nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier.
 2. Të mospranojë ankesën e operatorit ekonomik “VASAA” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62824-09-26-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike për sistemin e ndricimit rrugor dhe aksesore (shtylla ndriçimi, krahe një degshe etj)”, me fond limit 12,948,800 (dymbëdhjetë milion e nentëqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 14.10.2025, nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier.
 3. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “VASAA” SHPK në zbatim të vendimit të KSHA-së nr. 795/11 prot, datë 10.11.2025, dërguar me shkresën nr. 795/12 prot, datë 10.11.2025 “Dërgohet vendimi i KSHA në lidhje me ankesën për vlerësimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale elektrike për sistemin e ndricimit rrugor dhe aksesore (shtylla ndriçimi, krahe një degshe etj)”, me nr. REF-62824-09-26-2025”, protokolluar me tonën me nr. 3147/3 prot, datë 12.11.2025.
 4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vëre në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “VASAA” SHPK.
 6. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

